



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TEPELENË
KESHILLI BASHKIAK

Nr. 184/9. prot

Tepelenë më ,01 .02. 2023



N.9. datë 31/01/2023

“ PËR
MIRATIM DHËNIE NDIHME FINANCIARE PËR DËMIN E SHKAKTUAR NGA
ZJARRI “

Këshilli Bashkiak Tepelenë në mbledhjen e datës 31/01/2023 pasi mori në shqyrtim kërkesën e Bashkisë Tepelenë, për akordimin e ndihmës financiare për familjen e zotit Artur Ormeni fshati Sinanaj, njësia administrative Lopës, banesa e të cilit është dëmtuar nga zjarri, nga buxheti i bashkisë dhe i Ministrisë ë Mbrojtje për emergjencat civile për vitin 2023, në zbatim të ligjit nr.45/2019 “ Për Mbrojtjen Civile “ , neni 29 “komisioni i mbrojtjes civile në nivel qarku e bashkie” Neni 30 ku percaktohen detyrat e bashkive dhe perkatësisht gërma “gj” ku shprehet: “ kryejnë vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë në territorin e tyre, vlerësimin e nevojave për përbalimin e tyre si dhe dëmshperblejnë shtetasit për fatkeqësitë e ndodhura ne territorin e tyre”, neni 41 ”E drejta e kompensimit”, VKM Nr.329 date 16.05.2012 “ për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësit natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, Neni III, pika ë) “ Këshilli Bashkisë, pas shqyrtimit të relacionit të Komisionit të Emergjencave në Bashki, proces-verbalit të konstatimit të gjëndjes dhe dokumentacionit të vlerësimit të dëmeve, merr vendimin për dhënien e ndihmës financiare, në të cilin përmendet dhe masa e ndihmës së dhënë nga ky organ”.

V E N D O S I:

1. Të miratojë kërkesën e Bashkisë Tepelenë për mbështetje financiare të shtetasit Artur Ormeni, për dëmtimin e banesës së tij nga zjarri.
2. Të miratoj dokumentacionin tekniko-ligjor të hartuar nga Bashkia Tepelenë.

3. Ti akordoj familjes së shtetasit Artur Ormeni, ndihmën emergjente në vlerën **500179 lekë**, nga fondi i emergjencave civile i miratuar për vitin 2023 .
4. Ndihma financiare për familjen e mësipërme, përcaktohet sipas kritereve të VKM-së Nr 329 datë 16.05.2012 .
5. Ndihma financiare që do të akordohet do të përdoret për ti ardhur në ndihmë të familjes së shtetasit Artur Ormeni.
6. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6 e ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” të ndryshuar dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut, Gjirokastrë.

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Valbona ÇELA



Miratuar me 13(trembëdhjetë) vota
Vota Pro 13(trembëdhjetë)
Vota Kundër -
Vota Abstenim -
Zbardhur me datë 01.02.2023.

